

## **Komunikat për protestat e studentëve në Shqipëri.**

26.12.18

### **Komunikat e Rinisë për Emancipimin Komunist, për protestat e studentëve në Shqipëri.**

**Përshëndesim protestat masive studentore që kanë shpërthyer në të gjitha qytetet e mëdha të Shqipërisë:** më të mëdhat po zhvillohen në Tiranë por ata janë përhapur edhe në qytete të tjera të mëdha të vendit, siç janë Korça në jug, Elbasani në qendër dhe Durrësi në perëndim.

Lëvizja studentore në Shqipëri po lufton për të ulur tarifën, të cilat arrijnë deri në 2.560 euro, dhe përmisimin e kushteve në konvikte studentore, aty ku sot në dhoma të ngushta jetojnë edhe 8 studenta. Akoma, protestuesit kërkojnë përfaqësim më të madhë të studentëve tek administrimi i universiteteve por edhe libra falas (pasi librat të cilat profesorët e tyre i detyrojnë të blejnë janë të shtrenjta për ta). Gjithashtu kërkojnë rritje në buxhetin për arsimin, që sot është 3.3% e GDP-s. Shkaku për protestat ishte vendimi i qeverisë dhe universiteteve për të implementuar një haraç për mësimet që jipen gjat sezonit të Shtatorit, kjo VKM godet sidomos studentat më të varfër të cilët janë detyruar të punojnë paralel me shkollën. Parullat kryesore të studentëve janë: "Një rini që nuk rebelohet është një rini e vdekur", "Jemi studentë, jo klientë!"

**Është e qartë se problemet e popujve të Ballkanit, dhe sidomos të rinjve, janë të përbashkta:** Financimi i pamjaftueshëm i arsimit, tarifa, kushtet e mjerueshme të jetesës në konvikte, pengesa klasore, të varfërit mbesin qashtë arsimimit universitarë. Prandaj, shumica e cila goditet nga kjo gjëndje duhet të japi e bashkuar betejën kundër urrëjtjes të nacionalistave. Menyra më të cilën përdorën ngjarjen me Kacifa-n që të shpërndajnë helmin e racizmit trëgon edhe një herë të vërtetën e sloganit të njohur që thotë se: "Fashistët duan luftë civile të të varfërve, sepse janë cerat e bosave". Madje ky helmi racist kishte si rezultat vrasjen e një Shqiptari punojës tokë në Korfuz nga dora e një Nazisti. Nga ana jonë është e domosdoshme të paraqesim solidaritetin internacional të popujve, e cila sot përkthehet si mundje internacionale për Edukim- Bukë- Liri.

Më tepër, nuk duhet të harrohet që në fushën e arsimit publik kanë kaluar dhe po kalojnë një rrjeshtë reformash reaksionare, jo vetëm në Greqi dhe në Shqipëri, por në thuaj se të gjitha shtetet e Europës, duke ndjekur kërkesat e kapitalit. Lëvizje të mëdha me shkaqe të ngjashme janë zhvilluar gjatë dekadave të fundit dhe në Greqi kundër përpjekjeve për privatizimin e arsimit publik dhe vendosjen e pengesave të klasore. Këto lëvizjet arritën fitore të rëndësishme dhe është e paçmueshëm eksperiencia e EAAK (Lëvizja e Majt e Bashkuar e Pavarur), e degës antikapitaliste në lëvizjen studentore greke, që luajti një rol të rëndësishëm

në shpërthimin e protestave studentore në Greqi. Shumë nxënës dhe studentëta shqiptarë morën pjesë në mobilizimin dinamik në Greqi dhe përvojat tona janë të përbashkëta.

**Ne shpresojmë se studentët në Shqipëri do të jenë fitimtarë në këtë mundje.**

Përvojat e përbashkëta e dy popujve dhe pjesëmarrja e emigrantëve Shqiptarë në mundjet e përbashkëta në fushën shoqërore, në vendet e punës dhe në lëvizjen antifashiste janë e vetmja përgjigje tek helmi nacionalist që mundohet të na përçaj.

- **Fitore në mundjen e juan!**
- **Solidariteti është fuqija jonë!**

**Rinia për Emancipimin Komunis**

[Tweet](#)

---